



# Çështjet gjinore në menaxhimin e qendrueshëm të burimeve natyrore

Fiorela Shalsi  
Konsulente për çështjet gjinore, GWP-Med

# Zhvillimi i qëndrueshëm dhe barazia gjinore

- Zhvillimi i qëndrueshëm synon përmirësimin e ekonomisë dhe shoqërisë pa cënuar mjedisin natyror ose mirëqenien e brezave të ardhshëm
- Por që çdo përpjekje zhvillimore të jetë e qëndrueshme dhe efektive, duhet të marrë në konsideratë nevojat e të gjithë njerëzve, përfshirë edhe ata që tipikisht nuk kanë zë në vendimmarrje
- Kjo është arsyeja pse barazia gjinore është një përbërës kritik dhe i pandashëm për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm.

# Barazia gjinore dhe OZHQ-të

- Barazia gjinore mund të mundësojë dhe madje të përshpejtojë arritjen e të gjitha Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG).
- Ndërsa barazia gjinore është një qëllim më vete (SDG 5), përfitimet e saj shumëfishohen kur çështjet gjinore integrohen në të gjitha SDG-të.
- Adresimi i pabarazive gjinore – përfshirë edhe aksesin dhe kontrollin mbi burimet natyrore - përshpejton rezultatet e politikave drejt Axhendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

# Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore



- *“Përdorimi i burimeve natyrore në një mënyrë dhe me një ritëm që ruan dhe rrit qëndrueshmërinë e ekosistemeve si dhe përfitimet që ato ofrojnë. Duke vepruar kështu, plotësohen nevojave e brezave të tanishëm pa cënuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre”*

# Pabarazitë në akses dhe kontroll

- Ekziston një marrëdhënie komplekse dhe shumë dimensionale midis barazisë gjinore dhe politikave të burimeve natyrore.
- Kjo marrëdhënie përfshin
  - sferën prodhuese, me pabarazi të konsiderueshme në aksesin, kontrollin dhe menaxhimin e burimeve natyrore
  - punën përkujdesëse, me pabarazi disproporcionale në disfavor të grave
  - ndikimin e diferencuar nga ndryshimi i klimës dhe mjedisi

# Pabarazitë strukturore

Pabarazitë strukturore i vendosin gratë në disavantazh të qartë ekonomik dhe social: pabarazi të theksuara në pronësi dhe akses në burimet kryesore siç janë toka dhe uji, pabarazi në cilësinë e punësimit dhe në pozicionet e vendimmarrjes, dhe pabarazi në ekonominë e përdorimit të kohës që u përkeqësua veçanërisht në kontekstin aktual të pandemisë Covid-19.

Këto pabarazi përkthehen në një model të rritjes ekonomike të karakterizuar nga përjashtimi, pasi gratë nuk janë aq të mirëpozicionuara sa burrat për të përfituar nga mundësitë e krijuara nga rritja ekonomike.

Vëmendje të veçantë duhet të ketë mbi kontrollin dhe pronësinë e tokës, nga e cila përfitimet ekonomike shpërndahen në mënyrë të pabarabartë. Ky synim adresohet nga dy SDG të ndryshme të Axhendës 2030. Në Shqipëri vetëm 19% e pasurive të paluajtshme i përkasin grave.

# Pabarazitë kulturore

Ndryshimi i klimës pritet të përkeqësojë pasojat serioze të krizës mjedisore që ndikojnë ndryshe gratë dhe burrat, për sa kohë çështje si pakësimi i ujit, pakësimi i produktivitetit bujqësor apo shfaqja e sëmundjeve të reja lidhen veçanërisht me punën përkujdesëse që kryhet nga gratë.

Modelet e pabarabarta kulturore dhe rolet tradicionale gjinore në ndarjen e punës e përkeqësojnë situatën pasi gratë shpenzojnë më shumë kohë në punë të e papaguara, përkujdesëse për familjen, të cilat lidhen kryesisht me aksesin dhe sigurimin e burimeve natyrore të tilla si uji dhe energjia. Mungesa e aksesit në burime të tilla rrit kohën për kryerjen e punëve të shtëpisë, si dhe vulnerabilitetin veçanërisht të grave dhe vajzave.

# Pabarazitë në vendimmarrje

- Përrjashtimi i grave nga vendimmarrja është gjithashtu flagrant, në të gjitha nivelet e pjesëmarrjes ku merren vendime mbi burime të tilla si uji, deti, toka dhe pyjet. Ky përrjashtim duhet adresuar nga politikat e zhvillimit të këtyre sektorëve.
- Përrpjekjet për të adresuar pabarazitë duhet të identifkohen ndërlidhjet që ekzistojnë midis SDG-ve të ndryshme, ku ekziston një nevojë urgjente për një qasje integrale dhe shumëdimensionale, e cila nënkupton integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha politikat publike në lidhje me menaxhimin e burimeve natyrore.



# Barazia gjinore rrit qëndrueshmërinë

- Shumë nga pengesat për politika efektive të menaxhimit të qëndrueshëm gjenden në normat e vjetra diskriminuese shoqërore dhe në sistemet ligjore.
- Investimi tek vajzat dhe gratë nuk kërkon ndryshime rrënjësore të reja, por mund të thyejë pengesat sistemike të pushtetit dhe privilegjit që vazhdojnë të lënë pas miliona njerëz.



# Faleminderit

Fiorela Shalsi

Senior Gender Advisor